

iKM^{PLUS} në shkollën fillore

Të dashur prindër, të dashur kujdestarë ligjor!

Në pranverë 2022 do të fillojë **matja e kompetencës individuale PLUS (iKM^{PLUS})** për klasën e tretë fillore. Ajo ngre nivelin e nxënësit/ve në lëndët *Gjermanisht* dhe *Matematikë*. Tregon se ku ndodhet fëmija juaj në këtë moment dhe ku mund të vazhdojë të përmirësohet.

Rezultatet u ofrojnë mësuesve informacion/e shtesë për nxënësin/it e tyre. **Këto do ta ndihmojnë fëmijën tuaj të inkurajohet dhe mbështetet individualisht në mësim.** Rezultatet gjithashtu e ndihmojnë mësuesin për të reflektuar dhe zhvilluar më tej mësimin. Shkollat e përdorin informacionin për zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së shkollës.

Rezultatet nuk përfshihen në notë. Ato nuk shërbejnë si bazë për pranim në një nivel më të lartë shkollor.

Si funksionon iKM^{PLUS}?

Në kuadrin e iKM^{PLUS} fëmijëve u jepet një fletore detyrash në *Gjermanisht* dhe *Matematikë*, me të cilën ata duhet të punojnë gjatë orës mësimore.



iKM^{PLUS} zhvillohet në të gjitha shkollat fillore duke filluar nga 20 prilli deri në 10 maj të vitit 2022. Datat e sakta caktohen nga mësuesit dhe administrata e shkollës. Ju do të viheni në dijeni për datat drejtpërdrejt nga mësuesi përgjegjës ose administrata e shkollës.

iKM^{PLUS} zhvillohet tashmë në pak shkolla të përzgjedhura para festave të Pashkës. Kjo bëhet nga njerëz të trajnuar posaçërisht dhe shërben si masë e sigurimit të cilësisë.

A do t'i marr rezultatet e fëmijës tim?

Çdo fëmijë që merr pjesë në iKM^{PLUS}, do të marrë nga mësuesit përgjegjës të ashtuquajturin kod të **Reagimit**. Me këtë kod ju do të keni qasje të drejtpërdrejtë nëpërmjet internetit në rezultatin e fëmijës tuaj. Kodi do t'u shpërndahet nxënësve menjëherë sapo rezultatet të jenë të disponueshme.

Të gjitha të dhënat e mbledhura trajtohen me kujdesin maksimal dhe në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore. Vetëm mësuesi përgjegjës dhe administrata e shkollës mund t'i lidhin rezultatet me emrin e fëmijës përkatës. Përveç kësaj, askush nuk mund të shohë rezultatet e fëmijës suaj. Gjithashtu rezultatet nuk mund të përcillen nëpër shkolla të tjera.

Informacione të mëtejshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave mund të gjeni në <https://www.iqs.gv.at/datenschutz-ikmplus-schueler>.

Si veprohet më tej me rezultatet?

Rezultatet e iKM^{PLUS} do të diskutohen me ju gjatë bisedën së KEL-it (biseda fëmijë-prind-mësues) ose në ditën e takimit me prindër. Ju dhe fëmija juaj do të mësoni më shumë rreth rezultateve dhe do të bini dakord me mësuesin përgjegjës lidhur me objektivat e mëtejshme mësimore dhe hapat konkretë për fëmijën tuaj.

Sidoqoftë ftesën për intervistë do ta merrni me kohë nga mësuesi përgjegjës ose administrata e shkollës.

Ku mund të gjej informacione të mëtejshme?

Informacioni i përditësuar mund të gjendet në faqen e internetit të IQS (Instituti Federal për Sigurimin e Cilësisë në Sistemin Shkollor Austriak) dhe në faqen e internetit të BMBWF (Ministrisë Federale të Arsimit, Shkencës dhe Hulumtimit):

<https://www.iqs.gv.at/ikmplus>
<https://www.bmbwf.gv.at/Themen/schule/bef/ikmplus.html>



Këtu do të gjeni edhe informacion për prindërit lidhur me iKM^{PLUS} në shkollën fillore, të përkthyer edhe në gjuhë të tjera:

https://www.bmbwf.gv.at/Themen/schule/bef/ikmplus/ikmplus_elterinfo_ss2022.html



Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe bazën ligjore, mund të kontaktoni edhe zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave të IQS:

datenschutz@iqs.gv.at